

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica - Municipality of Gjakova

ARKIVA DALËSE
IZLAZNE ARHIVE
OUTPUT ARCHIVES

Nr. Inv/Br. Inv. 01-410/04-17198
Nr. Fajevë/Br. Str./No. Pj. 03.04.2025
Data/Datum/Date 03.04.2025

Gjakovë - Djakovica - Gjakova



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 03.04.2025

Në bazë të nenit 72.1 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, nenit 42.1, nenit 38, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër identifikimi : 632-17-043-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-3202, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore, me dt.03.04.2025, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, si pasojë e COVID-19 që shkaktoi vonesa të papritura dhe të pakontrollueshme në realizimin e projekteve publike dhe luftimeve tjera, ngjarje këto që shkaktojnë krizë globale ku edhe çmimet e lëndës së parë pësuan ndryshime të mëdha, pamundësuan realizimin e kontratës për pjesën e mbetur, kontrata me numër të identifikimi : 632-17-043-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-3202, e nënshkruar me datën 22.02.20218, me titull “Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, në Komunën e Gjakovës”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve N.N.Sh.”Korben” & “King Holding” sh.p.k, **NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.**
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës dhe Kryesi i punëve, në pajtim me nenin 42, paragrafi 42.1 dhe nenin 38, paragrafi 38.1 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), si dhe kërkesën e dt.28.03.2025, të menaxherit të kontratës, kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.

3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëshmipërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin e prokurimit për “Ndërtimi i Qendrës së Kulturës në Rogovë të Hasit, në Komunën e Gjakovës”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve N.N.Sh.”Korben” & “King Holding” sh.p.k, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës së dërguar me e-mail në Zyrën e Prokurimit me date 28.03.2025, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës.

Me date 02.04.2025, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për ndërprerje me marrëveshje të kontratës” te kryesi i punëve N.N.Sh.”Korben” & “King Holding” sh.p.k.- Gjakovë.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave të Prokurimit Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :


Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini



Kryetari i Komunës

Faton Gutaj

për: 
Zyrtar përgjegjës i prokurimit



Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
Menaxherit të kontratës;
Organit Mbikëqyrës;
Arkivës së Komunës.